



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBALI

Nga mbledhja Solemne e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 05 mars 2025, për nder të 27 vjetorit të Epopesë së UÇK-së

Mbledhja filloi në ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në Shtëpinë e Bardhë.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, znj. Antigona Bytyqi.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Shumë të nderuara familje të dëshmorëve, të martirëve, invalidëve dhe veteranë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të nderuar pjesëtarë të organizatave të dalura nga lufta, shumë i nderuar nënkryetar i komunës së Prizrenit zotëri Kujtim Gashi, ju të nderuar koleg kuvendar, drejtor, pjesëtar nga konsolata turke, nga forca e sigurisë së Kosovës, pjesëtar të policisë, përfaqësues nga Qrtk, i nderuar prefekti i parë i komunës së Prizrenit profesor Kadri Kryeziu, të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare, të bizneseve, shoqëritë civile, media, gjithë ju të pranishëm. Mirë se erdhët në seancën solemne të ftuar për nder të 27 vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Epopesë së 5, 6 dhe 7 marsit si një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e Kosovës. Kjo epope simbolizon sakrificën, guximin dhe vendosmërinë e popullit tonë për liri. Sot këto data të marsit kujtohen me shumë nderim si ditë të lavdisë dhe krenarisë kombëtare. Me rastin e manifestimit të epopesë kam kënaqësinë që fjalën t'ua kaloj përfaqësuesit e subjekteve politike. Ftoj përfaqësuesin nga Lëvizja Vetëvendosje.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesuese. Të nderuar familje të dëshmorëve, martirëve dhe veteranëve të UÇK-së, shoqata të dala nga lufta e UÇK-së, të nderuar udhëheqës të ushtrisë, policies së Kosovës, përfaqësues nga Kfori dhe konsullata turke, i nderuari kryetar i parë i Prizrenit zoti Kadri Kryeziu, nënkryetari Gashi, kolegë të nderuar, qytetarë të dashur të Prizrenit. Sot pas 27 vitesh me krenari kujtojmë ditët e Epope-së e UÇK-së, 5, 6 dhe 7 marsin e 1998-ës. Me krenari kujtojmë luftën e komandantit legjendar Adem Jashari. Me krenari kujtojmë sakrificën e madhe të Jasharëve legjendar. Në ditët e Epopesë UÇK-së u sprovuan vlerat më të larta të kombit. Trimëria, besnikëria dhe shpirti heroik i familjes së Jasharajve. Nuk ka përkufizim gjuhësor, historik dhe filozofik që kap përmasat e kësaj sakrifice. Përmasa e flijimit historik mori edhe dimensione legjendare. Në çdo përvjetor Epopeje ne do ta vëmë aktin e tyre në frazë sepse edhe me mijëra fraza të themi, akti i tyre mbetet i pa thënëshëm. Epopeja e familjes Jashari, u bë guri themeltar i lirisë dhe i shtetit tonë. Të nderuar të pranishëm, rezistenca dhe sakrifika sublime e familjes Jashari ishin dhe janë idealet për të mbrojtur lirin dhe të drejtën për të jetuar në liri. Këtë ditë, ne nderojmë

edhe të gjithë heronjtë, dëshmorët dhe martirët, të cilët nuk kursyjnë jetën e tyre për të realizuar një ëndërr që është bartur brez pas brezi lirinë. Ju faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit zot Haxhillari. Atëher vazhdojmë me përfaqësuesin nga PDK.

Adrit Krasniqi (PDK): Faleminderit kryesuese. Të nderuara familje të dëshmorëve, të nderuar invalidë e veteranë të luftës, të nderuar përfaqësues të bashkësive fetare, të nderuar përfaqësues të FSK-së, ju trashëgimtarë të UÇK-së, të nderuar pjesëtarë të policisë, i nderuar nënkryetar i komunës zoti Kujtim Gashi, i nderuar kryetar i komunës zoti Kadri Kryeziu, të nderuar kolegë, ekzekutiv, media, shoqëri civile. Jemi mbledhur sot në këtë ditë të shenjtë për historinë tonë kombëtare. Për të kujtuar, për të nderuar sakrificën e pavdekshme të komandantit legjendar Adem Jashari. Familjes e tij dhe të gjithë luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që dhanë jetën për lirin dhe dinjitetin tonë kombëtar. Epopeja e UÇK-së, e shkruar me gjak dhe sakrificë nuk është thjesht një kapitull i historisë sonë, por themeli mbi të cilën qëndron sot shteti ynë i lirë dhe sovran. Shtëpia e Jasharëve nuk ishte thjesht një shtëpi, por u kthye në një kështjellë të pathyeshme të lirisë. Armiku mendoi se duke i vrarë ata do ta shuante ëndrrën tonë për liri, por ndodhi e kundërta. Gjakimi për çlirim u bë edhe më i fortë, ndërsa Ushtria Çlirimtare e Kosovës u shndërrua në forcën e pamposhtur të popullit tonë. Nga ky refleksion Jasharajt paraqesin në mënyrë emblematike historinë më të re të Kosovës. Le të mos harrojmë kurrë se liria që gëzojmë sot nuk na është dhuruar. Është paguar me gjakun e dëshmorëve tanë. Lirinë sot po e paguajnë edhe shokët e Adem Jasharit. Hashimi, Kadriu, Rexha, Jakupi e shumë shokë të tjerë të cilët për herë të fundit po e dëshmojnë që lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk ishte një krim. Ajo ishte luftë çlirimtare, një betejë për të drejtat tona për lirinë dhe dinjitetin e popullit tonë. Ne si brez që gëzojmë lirin, kemi detyrë ta ruajmë dhe ta forcojmë këtë shtet. Kosova nuk duhet të jetë vetëm e lirë, por duhet të jetë e fuqishme, e drejtë dhe e begatë. Lufta për liri përfundoi, por lufta për drejtësi për zhvillim dhe për një të ardhme më të ndritur vazhdon. Lavdi e përjetshme e familjes Jashari, lavdi të gjithë të rënëve për liri dhe pavarësi.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit zoti Krasniqi. Tani ftoj përfaqësuesin nga LDK.

Marin Përgjoka (LDK): Të nderuar familjarë të dëshmorëve, invalidë e veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të nderuar anëtarë të kuvendit, përfaqësuesit të institucioneve, i nderuari prefekt i parë i Prizrenit profesor Kadri Kryeziu, të nderuar qytetarë të Prizrenit, zonja dhe zotërinj të pranishëm. Sot ne mbledhemi për të nderuar dhe kujtuar heroizmin dhe sakrificën madhështore të atyre që dhanë gjithçka për lirin që ne po gëzojmë. Data 6 dhe 7 mars na kujtojnë me krenari dhe mallë se çmimi i lirisë nuk mbatet vetëm me fjalë, por me sakrificë dhe dashuri të paparë ndaj atdheut. Në këto ditë zemrat e popullit janë të bashkuar në kujtesën e atyre që dhanë jetën për lirinë e vendit. Komandanti Adem Jashari dhe familja e tij u kthyen në simbol të qëndrueshmërisë dhe rezistencës ndaj padrejtësive, duke i ndriçuar rrugët për të gjithë popullin që të luftojnë për të drejtën tonë themelore, lirinë! Sakifica e familjes Jashari është një e thirrje për gjeneratat e tashme dhe të ardhme që të ruajnë historinë tonë dhe të respektojmë ata që kanë thënë gjithçka për lirinë tonë dhe të vazhdojmë rrugën e drejtë me përkushtim dhe unitet. Epopeja e UÇK-së nuk është vetëm një kujtim, por edhe krenari që na duket ta mbajmë të gjallë. Është një amanet që na obligon

të punojmë për një shtet të drejtë, demokratik, të zhvilluar ashtu siç e menduan dëshmorët tanë. Pa luftën çlirimtare, pa punën e jashtëzakonshme të presidentit historike Ibrahim Rugova, pa përkrahjen e miqve Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Evropës, Kosova nuk do të ishte kjo që është sot. Lavdi burrave dhe grave që punuan, luftuan dhe dhanë jetën për lirinë e atdheut. Lavdi komandantit legjendar Adem Jashari dhe familjes Jashari. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit zoti Përgjoka, atëherë vazhdojmë me përfaqësuesin nga AAK.

Agim Muçaj (AAK): Përsëritet kryesuese, ekzekutiv i nderuar, përsëritet përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta, zotëri Berisha, Is, Burim, të nderuar direkt trashëgimtarë të UÇK-së, Forca e Sigurisë së Kosovës, shërbimi policor i Kosovës, i nderuar profesor ish-kryetar i parë i Kuvendi të komunës po njëherë dhe një veprimtar i ilegalës. Shumë faleminderit për pjesëmarrjen tuaj. Media të nderuar, qytetarë të nderuar. Historia e popullit shqiptar në Kosovë e më gjerë është një histori dhe krenari e dhimbshme, ku me dekada dhe ndër shekuj luftuar për nder për të mbrojtur dinjitetin e tyre nga okupues të ndryshëm. Mirëpo kjo ishte një vullkan i pashuar dhe së fundi nga represjoni ushtarak-policor dhe politik i serbisë u mundua që ta zhdukim dinjitetin tonë. Për kundër përpjekjeve të serbisë shqiptarët vazhduan me përpjekjet e tyre për liri dhe shtet. Ky u bëri që Serbia të nuhat celulatat e para të UÇK-së, si edhe bëri sulmin dhe rrethimin e familjes Jashari. Sot e 27 vite më parë, data 5, 6 dhe 7 mars, e njohur si epopeja e UÇK-së. Është ngjarja më kulmore e historisë që përcjell ndërvite e lavdinë e luftës për liri. Në krye me komandantin legjendar Adem Jashari dhe familjen Jashari. Ku në këtë ngjarje Serbia u mundua që ta zhdukë dhe ta gënjëzojë popullin shqiptar, por nuk e arriti. Ku edhe 10 ditë më pas ose më mirë ta themi me 24 mars në Gllloxhanin e Harajdinëve u hap fronti tjetër dhe nga këtu në vazhdimësi UÇK filloi të organizohet në të gjithë territorin e Kosovës, me ushtarë nga vendi Shqipëri, diaspor duke u mobilizuar me një qëllim të vetëm. Duke u bazuar jo në epërsinë ushtarake, por në vlera njerëzore dhe luftën e drejtë, ata u shndërruan në pishtarë të luftës çlirimtare dhe gur themeltarë për lirinë, demokracinë dhe pavarësinë e shtetit tonë, e cila nuk arrihej kurrësi me mjete politike, por vetëm me mjete ushtarake. Pa luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjakun e derdhur të të rënëve, siç dhe ndihmën e faktorit ndërkombëtar gjegjësisht NATO, liria nuk do të arrihej. I nderuar kryetar, ekzekutiv, të nderuar kolegë, të gjitha partitë politike, unë sot sjell një mesazh për herë të dytë në këtë foltore, duke dedikuar familjet e dëshmorëve, veteranëve dhe invalidëve të cilët, të cilët vazhdojnë të shprehin pakënaqësitë e tyre nga politikëbërja jonë. Duke mos i përkrahur me dinjitet dhe duke i kujtuar vetëm formalisht me fotografi në ditët e caktuara festive siç është sot dhe nëpër fushata zgjedhore. Unë mendoj dhe pajtohen plotësisht me këtë drejtë, të cilën e sjellin nga shumë shokë dhe miq, len për të dëshiruar në kuvendin komunal, nga ekzekutivi dhe të gjitha organet varëse, sepse nuk janë duke u trajtuar këto kategori dhe familjet e tyre me dinjitet, si në shkollim, punësim, dhe e trajtim në jetën e tyre. Mirëpo kjo nuk është asgjë. Ne e dimë që qeverisja e fundit ose pesë vitet e fundit, kjo kategori e luftës është diskriminuar përtej masave që nuk është pritur asnjëherë. Pra kategoritë e lirisë u larguan nga ligji, u larguan nga paga minimale, e cila ka qenë e rregulluar me ligj. Qeverisë e ardhme, kushdo që është ajo, qoftë qeveria Kurti, apo cilado qeveri që do të vijë, kërkojmë që qysh në seancën e parë që të silllet ligji në parlament, të votohet, të merr formën e prerë dhe të kjo kategori të respektohet me dinjitet. Sepse dërgimi i dosjeve në gjykatë ka qenë padrejtësisht. Nuk ka prokuror dhe gjykatë, e cila mund ta trajton dhe të jep epilog këtij

farë lloj qëllimi të caktuar. Mendoj se është fundi që të kthjellemi, sepse ne nuk mund të arrijmë sukses para diplomatëve të huaj deri sa diskriminon vëllezërit tonë, ata të cilët dhanë më së shumti për këtë vend. Lavdi i familjes legjendar të Adem Jasharit, lavdi të gjithë herojve dhe martirëve të Kosovës. Faleminderit.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit zoti zotëri Muçaj, atëherë vazhdojmë me përfaqësimin nga Nisma.

Shukri Quni (Nisma): Të nderuar familjarë të dëshmorëve, invalidë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i nderuar nënkryetar i komunës zotëri Kujtim Gashi, të nderuar kolegë kuvendar, e nderuara kryesuese, të nderuar drejtor, përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës, trashëgimtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfaqësues të policisë së Kosovës, përfaqësues të Kforit, të bashkësive fetare, media gazetarë, shoqëri civile të nderuar të pranishëm. Sot po bëhen 27 vite nga lufta e Prekazit dhe beteja heroike e familjes së komandantit legjendar Adem Jashari. Ngjarje kjo që për çdo ditë është duke u madhështuar dhe përjetësuar në historinë e kombit tonë, për është një ngjarje që ndryshoi historinë e Kosovës dhe historinë kombëtare. Familja e Shaban Jasharit ishte bazë e cila u sulmua disa herë nga forcat serbosllave dhe si sulmi i parë ishte kur familja u sulmua me 30 dhjetor 1991. Duke e parë rrezikun nga Adem Jashari dhe nga baza e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sulmet që i organizonte Adem Jashari dhe njësite të UÇK-së, forcat serbe rrethojnë prapë dhe sulmojnë për të dytën herë familjen e Shaban Jasharit me 22 janar 1998. Forcat serbo-sllave pas disfatës që e pësuan më 22 janar 1998, kishin filluar përgatitjet për një sulm me përmasa më të mëdha me polici dhe ushtri, ku edhe filloi sulmi pikërisht sot 27 vite para mëngjesit, pra me 5 mars 1998. Këtë herë forcat e mëdha ushtarake dhe policore kishin rrethuar Prekazin dhe pikërisht ishin orientuar tek familja e komandantit legjendar dhe lagjen e Jasharajve. Për eliminimin e bazës së UÇK-së dhe familjes Jashari në krye me Adem legjendarin. Këtu ishte bërë një luftë e rreptë! Kemi edhe shokë që kanë qenë dhe kanë përjetuar gjithë atë Epope të 5-6-7 marsit. Këtë herë armiku kishte vendosur ta rrethojë dhe t'ia bëjë një rrethim të hekurt Prekazit legjendarë dhe familjes Jashari, me artilleri dhe armatim të rëndë. Pas një lufte dhe një rezistencë të madhe që e bëri Adem Jashari dhe familja Jashari, këto tri ditë ranë heroikisht dhe u vranë 55 vetë, në krye me komandantin legjendar Adem Jasharin. Armiku mendoi se do ta shkatërrojë këtë bazë, por jo! Ai kurrë njëherë nuk mundi me shkatërru, por ne vazhduam me vendosmëri luftën për liri dhe pavarësi. Të nderuar të pranishm, kjo luftë ishte një kushtim për të gjithë ne shqiptarët, kudo që ishim. Se lufta ka qenë e vetmja mënyrë që mund të shlirohet vendi dhe të rezultojë pastaj edhe me zgjerimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe nëpër pjesë të tjera të Kosovës dhe viseve të Kosovës për rreth, më vonë për Iliri, Preshev, Medvegj e Bujanoc. Dhe si rezultat i kësaj në 12 qershor 1999, Kosova çlirohet nga okupatori serb dhe më 17 shkurt 2008 ish-kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi shpall pavarësinë e shtetit sovran dhe të pavarur pra Republikën e Kosovës, ku sot ata mbahen padrejtësisht në Hagë, sëbashku me ish-kryetarin e parlamentit Jakup Krasniqi, Kadri Veselin, Rexhep Selimin, domethënë bashkëluftëtarët e Adem Jasharit. Të nderuar të pranishëm, pa luftën heroike të komandanti legjendar Adem Jasharit dhe familjes së tij, dhe pa gjakun e derdhur të gjithë dëshmorëve, nuk do ta kishim këtë liri. Pa luftën dhe gjakun e derdhur të heroit të kombit Remzi Ademaj, komandant Petritit, heroit të kombit Xhevat Berisha, Selajdin Berisha, Agim Shala, Besim Shala, Ysen Rexhepi, Ismail Kryziu dhe të gjithë dëshmorët dhe martirët që ranë në luftë kundër armikut serbosllav, ne nuk do ta kishim këtë

liri dhe këtë shtet që e kemi sot. Pra në fund, më fal se nuk përshëndeta në fillim, sepse jo, e meriton se je gjithnjë prezent këtu. Njëherit edhe ish-i-burgosën politik, profesor dhe kryetari i pari i komunës së Prizrenit, po dhe bashkëveprimtari i komandanti Remzi Ademaj, edhe një veprimtari të madhe që e ke, e gëzon një respekt jashtëzakonisht të madh. E kështu që të kërkoj falje se po rrësquesin nganjëherë gjërat. Andaj lavdi familjes Jashari, lavdi të gjithë dëshmorëve, lavdi Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ju faleminderit të gjithëve.

Ertan Simitçi (Ythp): Përshëndetje kryesuese, i nderuar nënkryetar, të nderuar ish-kryetari Kryeziu, përfaqësues të policisë, Ushtrisë Kosovës, përfaqësues të shoqatave të dalura nga lufta, të nderuar drejtorët, kolegët, kuvendarët, përfaqësues të mediave, i nderuai konsulati turk, përfaqësues të oj-q-ve të ndryshme dhe qytetarë të komunës së Prizrenit. Epoja e UÇK-së konsiderohet si një nga betejat më të lavdishme të luftës për çlirimin e Kosovës. Forcat serbe e kishin shënjestër komandantin e përgjithshëm të UÇK-së, Adem Jashari, pasi për ta ndalur fuqinë në rritje të UÇK-së, duhej eliminuar komandati i saj. Më 5 mars 1998, shtëpia e tij në Prekaz u rrethua nga njësitë ushtarake serbe. Rezistenca e Prekazit 5, 6, 7 marsi ishte një betejë që zgjati tri ditë e tri netë. Familja Jashari përballë mijëra ushtarëve serb dhe artilerisë së rëndë, nuk u dorëzua dhe qëndroi heroikisht deri në fund. Fatkeqësisht në përfundim të ditës së tretë, komandanti legjendar Adem Jashari dhe 55 anëtarë të familjes së tij ranë dëshmorë në këtë betejë. Ky akt tronditi thellë popullin e Kosovës. Tashmë kishte vetëm dy rrugë. Ose të dorëzoheshin përballë regjimit serb, ose të luftonin për liri duke mbështetur UÇK-n. Pas kësaj, rradhët e UÇK-së filluan të shtoheshin me mijëra luftëtarë të rinj. Populli mbështeti UÇK-n me të gjitha mjetet që kishte në dispozicion. Ndërkohë, komuniteti ndërkombëtar filloi të kushtonte më shumë vëmendje situatës në Kosovë, vetëm merrte masa kundër regjimit serb. Masakrat dhe krimet kundër njerëzimit që ndodhnin në Kosovë u bënë temë kryesore në organizata ndërkombëtare. Ndërsa UÇK-ja vazhdonte luftën në terren dhe ndërhyrja e NATO-s dhe në fund okupimit serb dhe kurorizoi luftën çlirimtare të Kosovës me fitore. Epopeja 5-6-7 marsi e njohur si epopeja e UÇK-së, u bë një moment historik në rrugën e drejtë të lirisë së Kosovës. Për këtë arsye Adem Jashari dhe familja e tij, do të mbetet përgjithmonë në kujtesën e kombit si heronj të pavdekshëm të lirisë. Në këtë në këtë ditë të shënuar përkulemi me respekt përpara veprës së komandantit legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të kombit dhe dua të theksoj se mirënjohja jonë për ta është e përjetshme. Nderimi dhe respekti ynë I përket gjithashtu veteranëve dhe invalidëve të luftës, të cilët dhanë gjithçka për këtë kauzë të shenjtë. Me këtë rast përshëndes me respekt të gjithë pjesëmarrësit në këtë ceremoni përkujtimore të epopes UÇK-së me 5-6-7 marsin. Pasi që nuk kemi pasur përkthim në gjuhën turke, do të vazhdoj edhe fjalimin në gjuhën turke.

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Faleminderit, zoti Simitçi, atëherë vazhdojmë me përfaqësuesin nga Komuniteti Boshnjak.

Sead Arifi (Vakat): 28:45- 30:40

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit zotëri Arifi. Tani kemi nderin që ta dëgjojmë një fjalim rasti edhe nga nënkryetari i komunës së Prizrenit zotëri Kujtim Gashi.

Kujtim Gashi (Nënkryetar i Komunës): E nderuara kryesuese e kuvendit zonja Antigona Bytyqi të respektuar asambleistë, drejtor dhe përfaqësues të institucioneve lokale të Prizrenit, të nderuar

familjarë të dëshmorëve, veteranë dhe invalidë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të nderuar përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zoti Is, Xhavit, Burim, Nuhi, Enver, faleminderit për prezencë. Shumë të respektuar përfaqësues të policisë Kosovës, komandant Faton, i nderuar ish kryetar i komunës profesor Kadri Kryeziu, të nderuar përfaqësues konsull i Republikës së Turqisë në Prizren, drejtor i Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, përfaqësues të komuniteteve të biznesit, gratë të nderuar që përfaqësoni organizatat e grave në Prizren. Mirë se kenë ardhur në këtë seancë solemne. Më lejoni që në emër tim dhe në emër të kryetarit të Prizrenit, zotit Shaqit Totaj, t'ju falenderoj për prani. Sot jemi mbledhur në këtë seancë solemne të Kuvendi të Komunës së Prizrenit për të kujtuar dhe nderuar një nga momentet më të lavdishme të historisë sonë kombëtare. Epopenë e UÇK-së në këto tri ditë të marsit 1998, Drenica dhe gjithë Kosova dëshmuar heroizmin dhe vendosmërinë e një populli që nuk pranoi të nënshtrohej përballë dhunës dhe padrejtësisë. Në zemrën e Drenicës në Prekaz, u ngrit një kala e pa mposhtur, shtëpia e familjes Jashari, e cila është shndërruar në simbol të qëndresës dhe sakrificës më sublime për lirinë e Kosovës. Komandanti legjendar Adem Jashari, së bashku me familjen e tij dhe luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u përballën me një armik të pamëshirshëm, duke dëshmuar se liria ka një çmim të lartë, por të panegociueshëm. Data 5, 6 dhe 7 mars, nuk janë thjesht ditë në kalendar, por janë tre ditët që ndryshuan përgjithmonë rrjedhën e historisë tonë. Për tri ditë e tri netë, forcat serbe hodhën mbi kullën e Jasharajve gjithçka që kishin. Municion, tanke, mortaja, por nuk mundën të shuanin flakën e lirisë. Ishte në përballje mes të mirës dhe të keqes, mes një populli që kërkonte të jetonte i lirë dhe një regjimi që synonte të shfaroste. Ne e dimë të gjithë përfundimin e asaj beteje. Familja Jasari ra heroikisht, por ata nuk u mposhtën. Ata u përjetësuan në simbol të qëndresës, krenarisë dhe dinjitetit tonë kombëtar. Gjaku i tyre nuk u derdh kot. Ai u bë thirrje për mijëra të rinj e të reja që iu bashkuan radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për ta vazhduar betejën që qoj në çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës. Sot, ndërsa qëndrojmë këtu, të lirë dhe krenar, duhet të kujtojmë se kjo liri është e fituar me gjak dhe sakrificë. Ajo erdhi falë trimërisë së familjes Jashari, mijëra dëshmorëve dhe luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, por edhe falë mbështetjes së aleatëve tanë strategjik, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Turqisë, NATO-s dhe partnerëve tonë evropian. Por amaneti i dëshmorëve tanë nuk ishte vetëm çlirimi. Ai ishte edhe ndërtimi i një Kosove të fortë, të drejtë dhe të bashkuar. Prandaj, është detyrimi ynë i përherëshëm që ta ruajmë dhe ta zhvillojmë këtë vend me dinjitet, integritet dhe përkushtim. Lavdi e përjetshme familjes së Adem Jasharit dhe të gjithë dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ju faleminderit

Antigona Bytyqi (Kryesuese e Kuvendit): Ju faleminderit i nderuar nënkryetar. Atëherë të nderuar të pranishëm duke ju uruar edhe njëherë për këto data të Lavdisë, ju falenderoj shumë për pjesëmarrjen dhe mirupafshim në seanca tjetër. Faleminderit shumë.

Mbledhja përfundoi në ora 10:35.

